

LIGJ
Nr.9705, datë 2.4.2007

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE TË
SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, institucioneve shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital të përbashkët me shtetin, personave juridikë e fizikë privatë dhe personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që detyrimet për kontributet të arkëtohen brenda datës 31.12.2007.

Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Pushohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për pjesën e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të cilat falen me këtë ligj.

Neni 3

Kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5266, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu